

**Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.**

**Pasqyrat Financiare i përgatitur bazuar në  
Ligjet dhe rregullat e Bankës Qëndrore të Kosovës  
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019  
Së bashku me raportin e audituesit të pavarur**

	PAGE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE .....	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË .....	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE .....	7-53

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për Menaxhimin dhe aksionarët e BANKA KOMBËTARE TREGTARE KOSOVË sh.a.****Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mijeteve monetare për vitin që mbyllt në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Bankës më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllt në këtë datë, në përputhje me Ligjet dhe Rregullat e Bankës Qëndrore të Kosovës sipas detajimeve të paraqitura në shënimin 2 të pasqyrave financiare.

**Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitet tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitet e Audituesit për Pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës së Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (Kodi BSNEK), së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare individuale në Kosovë dhe kemi përbushur përgjegjësitet e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Theksim çështje – Baza e përgatitjes së pasqyrave dhe kufizimet në përdorim**

Ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 2 të pasqyrave financiare, në të cilin përshkruhen bazat e përgatitjes së pasqyrave. Pasqyrat financiare janë përgatitur për të ndihmuar Bankën në përbushjen e kërkesave për raportimin financier të "Rregullores" së paraqitur më poshtë. Si rezultat, pasqyrat financiare mund të mos janë të përshtatshme për qëllime të tjera. Raporti ynë i auditimit ka për qëllim vetëm informimin dhe përdorimin nga Banka dhe Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të përdoret nga palë të tjera përvèç Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës. Opinion i auditimit nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

**Çështje të tjera**

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018, janë audituar nga një audite tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pa modifikuar për pasqyrat financiare në datën 15 prill 2019.

**Përgjegjësitet e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat financiare**

Drejimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Rregulloren e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës, siç është detajuar në Shënimin 2 të pasqyrave financiare, dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Bankës, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përvèç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financier të Bankës.

## Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave financiare individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të kriuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësimë të qëllimshme, keqinterpretim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rr Ethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasiguri materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare individuale dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, perveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

30 prill, 2020



Teit Gjini  
Auditues Ligjor



Mazars Kosova Sh.p.k  
NUI: 811335597  
Rr. Uxhin Hoti, Nr. 45/6, Prishtine  
[info@mazars.al](mailto:info@mazars.al) , [www.mazars.al](http://www.mazars.al)

**Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.**  
 Pasqyra e pozicionit Financiar më 31dhjetor, 2019  
 (Vlerat janë në EURO)

	Shënimë	31 dhjetor, 2019	31 dhjetor, 2018
<b>Pasuria</b>			
Paraja dhe balancat në Bankën Qendrore	6	68,789,883	53,319,751
Plasmanet dhe balancat në banka	7	37,244,984	18,278,042
Investimet në letra me vlerë	8	113,609,245	76,967,698
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	25	25,139	12,801,636
Kreditë për klientët, neto	9	306,393,983	242,918,160
Prona dhe paisjet	10	2,343,011	1,769,094
Pasuri me të drejtë përdorimi	3	2,799,428	-
Pasuritë e paprekshme	11	12,052	22,414
Të arkëtueshmet nga tatimi	27	-	360,903
Pasuri të tjera	12	5,287,986	4,106,862
<b>Gjithsej pasuria</b>		<b>536,505,711</b>	<b>410,544,560</b>
<b>Detyrimet</b>			
Depozitat e klientëve	13	449,152,204	351,354,331
Detyrimet ndaj bankave	14	4,661,073	17,859,118
Detyrimet ndaj BKT Shqipëria	25	774,405	-
Detyrimi i tatimit në të ardhura	27	196,960	-
Provizonet	24	20,275	-
Shpenzimet e përllogaritura dhe detyrime të tjera	15	2,299,888	1,710,039
Detyrimet e qirasë	3	2,841,154	-
Huamarrjet	16	22,283,169	4,085,314
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>482,229,128</b>	<b>375,008,802</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar		22,000,000	17,000,000
Fitimi i akumuluar nga vitet paraprake		18,845,120	13,802,293
Fitimi për vitin		10,167,652	5,042,827
Rezerva e vlerës së drejtë		3,263,811	(309,362)
<b>Gjithsej kapitali aksionar</b>	<b>17</b>	<b>54,276,583</b>	<b>35,535,758</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar</b>		<b>536,505,711</b>	<b>410,544,560</b>

Pasqyra e audituar e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 53 që janë pjesë e informacionit financiar të audituar.

Pasqyrat financiare janë autorizuar për lëshim nga Bordi i Drejtoreve më 03 Mars 2020 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

**Suat Bakkal**  
 Kryeshef Ekzekutiv dhe Anëtarë Bordi

**Agon Skeja**  
 Drejtues i Grupit të Financave dhe Administratës

**Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.**

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në *EURO*)

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Interesi</i>			
Të ardhurat nga interesë	18	21,299,799	16,429,668
Shpenzimet e interesit	19	(4,220,136)	(2,889,809)
<b>Të ardhurat neto nga interesë</b>		<b>17,079,663</b>	<b>13,539,859</b>
<i>Të ardhurat nga jo-interesi, neto</i>			
Tarifat dhe komisionet, neto	20	3,637,206	3,249,746
Fitimi nga rivlerësimi i kursit të këmbimit, neto		(96,778)	19,192
Fitimi/(Humbja) nga shitja e letrave me vlerë		974,325	417,115
Fitimi / (Humbja) nga aktivitetet tregtare me valuta te huaja, neto		262,033	78,086
Të ardhura/Shpenzime të tjera, neto	21	34,948	393,745
<b>Gjithsej të ardhurat e tjera, neto</b>		<b>4,811,734</b>	<b>4,157,884</b>
<i>Shpenzimet operative</i>			
Shpenzimet e personelit	22	(4,315,654)	(3,941,998)
Shpenzimet administrative	23	(4,762,223)	(5,089,444)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(1,726,638)	(641,750)
<b>Gjithsej shpenzimet operative</b>		<b>(10,804,515)</b>	<b>(9,673,192)</b>
Shpenzimet e provizioneve për kreditë e klientëve	9	371,895	(2,433,253)
Shpenzimet e provizioneve për pasuritë financiare, përvëç kredive ndaj klientëve	24	(229,694)	3,008
<b>Fitimi para tatimit në fitim</b>		<b>11,229,083</b>	<b>5,594,306</b>
<b>Shpenzimet e tatimi në fitim</b>	27	<b>(1,061,431)</b>	<b>(551,479)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(1,061,431)	(551,479)
<b>Fitimi (Humbja) për vitin</b>		<b>10,167,652</b>	<b>5,042,827</b>
Rivlerësimi i investimeve ne letra me vlerë		3,573,173	(270,157)
<b>Të ardhura/shpenzime tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>3,573,173</b>	<b>(270,157)</b>
<b>Gjithsej (humbja)/fitimi gjithëpërfshirës për vitin</b>		<b>13,740,825</b>	<b>4,772,670</b>

Pasqyra e audituar e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 53 që janë pjesë e informacionit financier të audituar

**Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.**

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në *EURO*)

	Kapitali aksionar	Rezervat e vlerës së drejtë	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>	<b>17,000,000</b>	<b>(39,205)</b>	<b>13,802,293</b>	<b>30,763,088</b>
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në capital	-	-	-	-
Kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët	-	-	-	-
Rritja në kapitalin aksionar	-	-	-	-
<b>Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në capital</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>				
Fitimi për vitin	-	-	5,042,827	<b>5,042,827</b>
Rivlerësimi i letrave me vlerë të disponueshme për shitje, pa tatim mbi të ardhurat	-	(270,157)	-	(270,157)
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>(270,157)</b>	<b>5,042,827</b>	<b>4,772,670</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>17,000,000</b>	<b>(309,362)</b>	<b>18,845,120</b>	<b>35,535,758</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2019</b>	<b>17,000,000</b>	<b>(309,362)</b>	<b>18,845,120</b>	<b>35,535,758</b>
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapital				
Kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët	-	-	-	-
Rritja në kapitalin aksionar	5,000,000	-	-	5,000,000
<b>Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në capital</b>	<b>5,000,000</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>5,000,000</b>
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>				
Fitmi për vitin	-	-	10,167,652	10,167,652
Rivlerësimi i investimeve ne letra me vlerë	-	3,573,173	-	3,573,173
<b>Gjithsej fitimi gjithëpërfshirës për vitin</b>	<b>-</b>	<b>3,573,173</b>	<b>10,167,652</b>	<b>13,740,825</b>
<b>Gjenda më 31 dhjetor 2019</b>	<b>22,000,000</b>	<b>3,263,811</b>	<b>29,012,772</b>	<b>54,276,583</b>

Pasqyra e audituar e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 53 që janë pjesë e informacionit finansiar të audituar.

**Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.**

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në *EURO*)

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:</b>			
Fitimi para tatimit për vitin		<b>11,229,083</b>	<b>5,594,306</b>
<i>Rregullimet për të barazuar ndryshimet në pasuritë neto me paratë e gatshme neto nga aktivitetet operative:</i>			
Shpenzimet e interest	19	4,220,136	2,889,809
Të ardhura nga interesi	18	(21,299,799)	(16,601,995)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	1,726,638	641,750
Fitimi/Humbja nga heqja nga përdorimi i pasurive fikse		(50,887)	-
Fitimi / humbja nga shitja e letrave me vlerë të investimeve		(974,325)	(417,115)
Fitimi për rikuperimin e kredive të shlyera për klientët		(201,765)	(367,608)
Fshirja e kredive për klientët		3,233,656	781,513
Të ardhura të tjera jo-monetare		-	-
Zhvlerësimi i kredisë për klientët		1,197,992	2,433,253
Zhvlerësimi i pasurive të tjera financiare		229,694	(3,008)
Zhvlerësimi i pasurive të tjera financiare (pasuritë e riposeduara)		314,293	32,612
<b>Rrjedha e parasë nga fitimi operativ para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative</b>		<b>(375,284)</b>	<b>(5,016,483)</b>
<i>(Rritja)/Zvogëlimi në pasuritë operative:</i>			
Balancat e kufizuara me Bankën Qendrore		(5,765,776)	(2,700,896)
Plasmanet dhe balancat me banka		(3,044,223)	(851)
Kreditë për bankat		-	30,500,000
Kreditë për klientët		(66,969,329)	(39,659,223)
Të arkëtueshmet nga BKT Shqipëria		12,776,497	(8,769,331)
Pasuri të tjera		(1,134,515)	850,945
		<b>(64,137,346)</b>	<b>(19,779,356)</b>
<i>Rritja/(Zvogëlimi) në detyrimet operative:</i>			
Detyrimet ndaj klientëve		97,361,361	49,377,178
Detyrimet ndaj bankave		(13,177,663)	17,835,624
Detyrimet ndaj BKT Shqipërise		774,405	-
Shpenzimet e përllogaritura dhe detyrime të tjera		291,485	(900,825)
		<b>85,249,588</b>	<b>66,311,977</b>
<i>Interesi i paguar</i>			
Interesi i paguar SNRF 16		(3,686,157)	(2,588,268)
Interesi i pranuar		(99,994)	-
Tatimet në të ardhura të paguara		19,448,176	16,161,336
		(508,768)	(784,181)
<b>Rrjedha neto e parasë nga / (përdorur në) aktivitetet operative</b>		<b>35,890,215</b>	<b>54,305,025</b>
<b>Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese</b>			
Të ardhurat nga shitja e letrave me vlerë të investimeve		(31,378,003)	(21,095,898)
Blerjet e pasurive dhe pajisjeve		(1,447,055)	(425,067)
Të ardhurat nga shitja e pronave, bimëve dhe pajisjeve		50,887	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga / (përdorur në) aktivitetet investuese</b>		<b>(32,774,171)</b>	<b>(21,520,965)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>			
(Pagesat e)/ të ardhurat nga detyrimet ndaj bankave		18,179,999	(1,820,000)
Shtimi i kapitalit		5,000,000	-
Ndryshimi në kryegjënë e qirasë		(801,412)	-
<b>Rjedha neto e parasë nga aktivitet financuese</b>		<b>22,378,587</b>	<b>(1,820,000)</b>
<b>Rritja neto ne Paratë dhe ekuivalentët e parasë</b>		<b>25,494,631</b>	<b>30,964,060</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës	6	46,015,591	15,051,531
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të periudhës</b>	6	<b>71,510,222</b>	<b>46,015,591</b>

Pasqyra e audituar e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 53 që janë pjesë e informacionit finansiar të audituar.

## **Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

### **1. Të përgjithshme**

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a ("Banka") është një bankë komerciale e cila ofron një gamë të gjerë të shërbimeve. Banka ofron shërbime bankare për kompanitë publike dhe private, si dhe individëvë në Kosovë.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a. ("Banka") është në pronësi të plotë të bankës shqiptare Banka Kombëtare Tregtare sh.a. ("BKT"). BKT- Kosova është regjistruar më 30 gusht 2007 në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK"), për të vepruar si bankë në Republikën e Kosovës dhe është subjekt i rregulloreve të BQK-së.

Më 30 Prill, 2018, Banka Kombëtare Tregtare Dega në Kosovë ndryshoi statusin e saj nga dega e huaj në Shoqëri Aksionare. Licensa e saj bankare ndryshoi nga Banka Kombëtare Tregtare - Dega në Kosovë në Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a

Banka ofron një gamë të gjerë të shërbimeve universale për ndërmarrjet private dhe shtetërore, dhe individët në Republikën e Kosovës. Burimi kryesor i financimit të Bankës janë depozitat, të cilat janë pranuar në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat dhe pa afat, si në Euro ashtu edhe në valutë të huaj. BKT ofron një shumëlojshmëri të kredive të korporatave dhe të konsumit, karta debiti dhe krediti, shërbime përmes bankomatit, kanale alternative të sofistikuara, shërbime të kualifikuara ndërkombëtare bankare dhe produkte të ndryshme të thesarit.

Rrjeti i BKT Kosova përfshin 26 njësi. Shtatë njësi janë të vendosura në Prishtinë, dhe njësitë e tjera janë të vendosura në Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtrri, Fushë Kosovë, Podujevë, Drenas, Rahovec, Viti dhe Lipjan, Aeroporti i Prishtinës dhe Skenderaj.

Numri i të punësuarve në fund të vitit 2019 ka qenë 358 (2018: 358).

### **Kapitali aksionar**

Me 31 dhjetor 2019 kapitali aksionar i autorizuar është EUR 22,000,000 (2018: EUR 17,000,000). Banka është një shoqëri aksionare 100% në pronësi të Banka Kombëtare Tregtare sha në Shqipëri. Të gjitha aksionet e emtuara janë të paguara plotësisht. Bartësi i aksioneve ka të drejtë të marrë dividëntë, nëse ato deklarohen. Të gjitha aksionet janë të rankuara njësoj marrë paraqyshë asetet reziduale të Bankës.

Mbi vendimin e aksionarëve të datës 20 Mars 2019, kapitali i bankës ishte rritur nga EUR 17,000,000 në EUR 22,000,000 përmesinjektit të kapitalit performuar më 20 Qershor 2019.

### **2. Bazat e përgatitjes**

#### **(a) Deklarata e pajtueshmërisë**

Banka mban shënimet e saj kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare ligjore të saj në përputhje me parimin e kostos historike dhe rregullat e rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("Rregullat BQK") të aplikueshme për Bankën. Rregullat e BQK-së janë të bazuara në vendimin përkatës ligjor, duke definuar zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") në Kosovë, dhe kërkesat tjera specifike, në veçanti në lidhje me vlerësimin e lejimeve për provisionet e kredive dhe pasurive financiare. Kërkesat e tillë specifike nuk janë në përputhje me kërkesat specifike të SNRF në këtë çështje. Përgatitja e pasqyrave financiare konform rregullave te BQK-së kërkon nga menaxhimi të bëjë vlerësimë dhe supozime që kanë ndikim në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, shpalosjen e pasurisë dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare, dhe shumave të raportuara të të hyrave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës raportuese. Edhe pse këto vlerësimë janë të bazuara në njojuritë më të mira të menaxhmentit për ngjarjet dhe veprimet aktuale, rezultatet e tanishme munden përfundimisht të ndryshojnë nga këto vlerësimë. Shifrat aktuale dhe krahasuese të cekura në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Euro.

#### **(b) Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përvèç pasurive financiare në dispozicion për shitje, të cilat janë të matura me vlerën e drejtë dhe pasurive të mbajtura për investim, të cilat po ashtu janë të matura me vlerë të drejtë.

Për më tepër, për qëllime të raportimit financier, matjet me vlerën e drejtë kategorizohen në Nivelin 1, 2 ose 3 në bazë të shkallës në të cilën të dhënat për matjen e vlerës së drejtë janë të vëzhgueshme dhe mund të kenë një efekt të rëndëshëm në tërësinë e tij, të cilat janë përshkruar si më poshtë

## **Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

---

### **2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**

#### **(b) Bazat e përgatitjes**

- Niveli 1 përfshin të dhënrat me çmimet e kuotuara (të pakorrigjuara) në tregjet aktive për pasuritë e njëjtë ose detyrimet që ndërmarrja mund t'i u qaset në datën e matjes;
- Niveli 2 përfshin të dhënrat përvèç të dhënave me çmimet të kuotuara të përfshira në Nivelin 1, që janë të vëzhgueshme për pasuritë dhe detyrimet, qoftë në mënyrë direkte apo indirekt; dhe
- Niveli 3 të dhënrat që janë të pa vëzhgueshme për pasuritë ose detyrimet..

#### **(c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro, e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Bankës.

#### **(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëj gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekur.

Informacionet mbi fushat kryesore të vlerësimit të pasigurive dhe mbi gjykimet kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimin 4.

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me politikat e kontabilitetit të përshtatura në Pasqyrat e fundit financiare të Bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019.

#### **(a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale të Bankës me kursin e këmbimit të momentit në datën e kryerjes së transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare në valutë të huaj në datën e raportimit janë rikonvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit momental në atë datë. Fitimi ose humbja nga zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar së monedhës funksionale në fillim të periudhës, rregulluar përi interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me normën e këmbimit në fund të periudhës. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë, rikonvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të çastit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të cilat janë deklaruar me kostot historike, janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

#### **(b) Interesi**

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma që skonton pagesat e vlerësuara të parave në të ardhmen dhe arkëtimet përgjatë jetës së pasurisë ose detyrimit financier (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të pasurisë ose detyrimit financier. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financier, por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritia e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen ose emetimin e një pasurie apo detyrimi financier.

## **Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

---

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(c) Tarifat dhe komisionet**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një pasuri ose detyrim financier, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura tjera nga komisionet ose tarifat janë njojur posa shërbimet e lidhura me to kanë ndodhur. Ndërsa shpenzime të tjera nga tarifat dhe komisionet lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat njihen si shpenzime posa shërbimet të pranohen.

#### **(d) Pagesat e bëra për qiranë**

Pagesat e bëra për qiranë operative janë njojur në fitim dhe humbje në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. Pagesat e ardhshme të qirasë kontabilizohen duke rishikuar pagesat minimale të qirasë për periudhën e mbetur të qirasë, kur rregullimet dhe përshtatjet në qira konfirmohen.

#### **(e) Tatimi aktual dhe i shtyrë në të ardhura**

Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në fitim ose humbje me përjashtim të masës që lidhet me zërat e njojur drejtpërdrejt në kapitalin neto ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore të miratuar ose të nxjerra në mënyrë substanciale në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është dhënë për diferençat e përkohshme ndërmjet vlerës neto kontabël të pasurive dhe detyrimeve për qëllime raportimi financier dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferençave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, në bazë të ligjeve të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse mund të ketë taksa dhe interesa shtesë. Banka beson se përllogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të mjaftueshme për të gjitha vitet tatimore bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimet e ligjit të taksave dhe përvjelles së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri të gjykimeve rrëth ngjarjeve të ardhshme. Informata të reja mund të vinë në dispozicion që të ndikojnë te Banka për të ndryshuar vendimin e saj në lidhje me mjaftueshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; ndryshime të tillë të detyrimeve tatimore do të ndikojnë në shpenzimet e tatimit në periudhën që një përcaktim i tillë është bërë.

Tatimi i shtyrë – pasuri njihet deri në masën që është e mundur që fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoret pasuria e tillë. Tatimi i shtyrë - pasuri rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që përfitimet nga pasuria e tillë nuk është e mundur më të realizohen.

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, nuk ka diferenca të përkohshme që do të kërkonin njojen e një pasuri ose detyrimi tatimor të shtyrë në pasqyrat financiare.

## **Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

---

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare**

##### **(i) Njohja**

Banka fillimisht njeh kreditë, depozitat, instrumentat e borxhit të emetuara dhe detyrimet vartëse në datën në të cilën ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka zotohet për të blerë ose shitur pasurinë. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një pasuri ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus (për një pozicion i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tij.

##### **(ii) Ç'regjistrimi**

Banka ç'regjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuale të flukseve monetare nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferon të drejtat përmarrë rrjedhjet e kontraktuara të parasë mbi pasurinë financiar në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë në fjalë janë transferuar. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që është krijuar ose mbajtur nga Banka njihet si një pasuri apo detyrim i veçantë.

Banka ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Banka merr pjesë në transaksione përmes të cilave transferon pasuri të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pasurisë së transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë pasuritë e transferuara nuk ç'registrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i pasurive të tillë te të cilat mbahen të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin, për shembull, huadhëni dhe transaksionet e riblerjes.

Kur pasuritë i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi të njëkohshme swap mbi pasurinë e transferuar, transaksiu kontabilizohet si një transaksion i siguar i financimit i ngjashëm me transaksionet e riblerjes. Në transaksione për të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një pasurie financiare, e ç'regjistron pasurinë nëse nuk mban kontroll mbi të. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura nga transferimi janë të njohura veçmas si pasuri dhe detyrime, sipas rrethanave në menyrën më të përshtatshme. Në transferimet në të cilën kontrolli mbi pasurinë ruhet, Banka vazhdon të njohë pasurinë në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme në lidhje me pasurinë, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e eksposuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

Në disa transaksione, Banka mban detyrimin për të ofruar shërbime për pasurinë financiare të transferuar në këmbim të një tarife. Aktivi i transferuar ç'registrohet tërësisht nëse plotëson kriteret e ç'regjistrimit. Një pasuri ose detyrim njihet për kontratën e shërbimit, në varësi të faktit nëse tarifa e shërbimit është më shumë se mjaftueshëm (pasuri) ose është më pak se mjaftueshëm (detyrim) për kryerjen e shërbimit.

Banka e shlyen një vlerë të kredisë/ letër me vlerë (dhe çdo nga shpenzimet e provizonimeve) me vendimin e Bordit të Drejtoreve, në përputhje me Rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës "Për Menaxhimin e Riskut Kreditor". Procedura e shlyerjes fillohet pasi kredia klasifikohet në kategorinë HUMBJE dhe duke marrë parasysh llojin e kolateralit. Eksposimet që nuk sigurohen me kolateral do të shlyhen 12 muaj pasi eksposimi është klasifikuar në kategorinë HUMBJE, eksposimet e siguruara me kolateraldo të shlyhen 24 muaj pasi eksposimi është klasifikuar në kategorinë HUMBJE dhe eksposimet e siguruara me hipoteka do të shlyhen 48 muaj pasi eksposimi është klasifikuar në kategorinë HUMBJE.

##### **(iii) Kompensimi**

Pasuritë dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të shesë pasurinë dhe njëkohësisht të shlyejë detyrimin. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standartet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtues të Bankës.

## **Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

---

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

##### **(iv) Matja e kosotove të amortizuara**

Kostoja e amortizuar e një pasurie ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet kur njihet fillimi, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën efektive të interesit të çdo diferenca ndërmjet vlerës fillestare të njojur dhe shumës së maturimit, minus çdo zbritje për efekt rënje në vlerë.

##### **(v) Matja e vlerës së drejtë**

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një pasuri mund të shkëmbhet, ose një detyrim të shlyhet, midis palëve të vullnetshme që kanë informata e duhura, në një transaksion në kushte të tregut në datën e matjes.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuara në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuara janë të gatshme dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksionet aktuale të tregut si dhe rregullisht ndodhin në kushte të lira tregu.

Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të kryera midis palëve të vullnetshme që kanë informacionin e duhur (nëse ka), duke iu referuar vlerës së drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjtë, analizat e flukseve monetare të skontuara dhe modelet e çmimeve të opsiioneve.

Teknika e zgjedhur e vlerësimit përdor maksimumin e faktorëve të tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të Bankës, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në përcaktimin e çmimit, dhe është në përputhje me metodologjitet ekonomike të pranuara për vlerësimin e instrumentave financiarë. Faktorët për teknikat e vlerësimit paraqesin në mënyrë të arsyeshme pritshmëritë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentet financiare. Banka klasifikon metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmérinë duke përdorur çmimet nga transaksionet aktuale të tregut për të njëjtin instrument ose të dhëna të tjera te disponueshme dhe të vëzhgueshme në treg.

Evidencia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar për njojen fillestare është çmimi i transaksionit, do të thatë, vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë, përvèç nëse vlera e drejtë e këtij instrumenti është evidentuar nga krahasimi me transaksione aktuale të tregut për të njëtin instrument (d.m.th. pa modifikim ose ripërpunim) ose bazuar në një teknikë vlerësimi variablat e të cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të vezhguara.

Kur çmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë për njojen fillestare, instrumenti financiar matet fillimi me çmin e transaksionit ndërsa çdo diferenca midis këtij çmimi dhe vlerës të marrë fillimi nga një model vlerësimi njihet më pas në fitim ose humbje varësish nga faktet e veçanta dhe rr Ethanat e transaksionit, por jo më vonë se kur vlerësimi është mbështetur plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose transaksi të shtë e myllur.

##### **(vii) Zhvlerësimi i aseteve financiare**

###### **Kreditë dhe paradhënet për klientët**

Kreditë dhe paradhënet për klientët raportohen neto nga zhvlerësimi (ose neto nga provisionet për humbjet e kredisë). Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka prova objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar. Pasuritë financiare janë zhvlerësuar kur provat objektive tregojnë se një ngjarje ku vërtetohet se ka humbjeje ka ndodhur pas njojjes fillestare të asetit, dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në rrjedhën e ardhshme të parave të asetit.

Provizonet për humbjet nga kreditë janë krijuar në bazë të rregullores "Menaxhimi i rezikut kreditor" i cili është miratuar nga BQK-ja më 26 prill 2013. Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë kreditë në pesë kategori të rezikut. Banka konsideron dëshmitë për provizionet për kreditë dhe paradhënet si në nivelin specifik ashtu edhe ne atë të përgjithshëm. Kreditë dhe paradhënet që nuk janë provizionuar specifiksht, vlerësohen në mënyrë kolektive për provizionim duke grupuar së bashku kreditë dhe paradhënet me karakteristika të ngjashme të rezikut. Provizonet e krijuara për humbjet e mundshme në kreditë e klasifikuara si standarde dhe vrojtuese klasifikohen si provizionet të përgjithshme.

## **Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

- (f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)**
- (vii) Zhvlerësimi i aseteve financiare (vazhdim)**

Për çdo kategori të rrezikut, aplikohen normat minimale të prozioneve të veçantë si në vijim:

Kategoria	Normat e vecanta të provozioneve
Standard	Modeli roll rate
Vrojtuese	Modeli roll rate
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Humbje	100%

Evidencia objektive që pasuritë financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë vonesën ose delikuencën nga një huamarrës, ristrukturimin e një kredie ose paradhënie nga Banka, sipas kushteve që Banka nuk do ta konsideronte ndryshe, indikacionet se një huamarrës ose emetues do të hyjë në falimentim, zhdukjen e një tregu aktiv për letrat me vlerë ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme në lidhje me një grup pasurish të tillë si ndryshime të pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësve në Bankë, ose kushtet ekonomike që lidhen me mospagim në Bankë.

Banka rishikon portofolin e kredive për të përcaktuar humbjet nga rënia në vlerë në baza mujore. Për të përcaktuar nëse një humbje nga rënia në vlerë duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Banka bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregon se ka një ulje të ndjeshme në flukset e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare nga një portofoli i kredive përpëra se kjo rënie të identifikohet në një kredi specifike të atij portofoli. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në grup, ose në kushte ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me mungesat e aktiveve në grup. Menaxhimimi kur cakton flukset e ardhshme të parasë përdor vlerësimë të bazuara në përvojën historike për humbjet nga asetat me karakteristika të rrezikut të kreditit dhe dëshmi objektive të rënies në vlerë të ngjashme me ato në portofol. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar edhe sasinë edhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferençat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes.

## Përcaktimi I vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për pasuritë dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ekziston një çmim tregu i vëzhgueshëm kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç pëershruhet në politikat kontabёl 3 (e) (vi). Për instrumentet financiare të cilat tregtohen rrallë dhe që kanë transparencë të vogël të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimisë në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve të çmimeve dhe rreziqeve të tjera që ndikojnë mbi instrumentin e caktuar. Shih gjithashtu "Vlerësimi i instrumenteve financiare" më poshtë.

Gjykimet kritike kontabël të bëra në zbatimin e politikave kontabël të Bankës përfshijnë:

## Vlerësimi i instrumenteve financiare

Politika kontabël e Bankës për matjen e vlerës së drejtë është diskutuar në shënimin 3 (f) (viii).

Banka mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmimin e kuotuar të tregut-në një treg aktiv për një instrument të ngjashëm.
  - Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuara në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuara për instrumente të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktivë; ose teknika tjera vlerësimi ku të gjithë faktorët kyç janë në mënyrë direkte ose indirekte të vëzhgueshëm nga të dhënat e tregut.
  - Niveli 3: Teknikat e vlerësimit duke përdorur të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet ku metoda e vlerësimit përfshin faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme mund të kenë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuara për instrumente të ngjashme ku rregullime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime kërkohen për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime tregut të kuotuara ose kuotime çmimesh nga tregtarëtuesit. Për të gjitha instrumentet financiare të tjera Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknikat e vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të parave, kahasimin me instrumente të ngashme për të cilat ekzistojnë çmime tregut të mbikëqyrur, modelin "polinomial" të çmimeve të opsiioneve dhe metoda tjera të vlerësimit. Synimi i teknikave të vlerësimit është që të arrihet në përcaktimin e një vlere të drejtë, që pasqyron çmimin e një instrumenti finanziar në datën e raportimit që do të ishte i njejtë me çmimin e dalë nga ndërveprimi i pjesmarrësve gjatë një periudhe afatshkurtër në një treg aktiv.

## **Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvrësime kur specifikohen ndryshe)

---

### **4. Përdorimi I vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

Banka për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve më të zakonshme dhe më të thjeshta përdor modele të vlerësimit të njohura gjérësish siç janë swap-et e normave e interesit dhe monedhave që përdorin vetëm të dhëna të publikuara tregu dhe që kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim nga menaxhmenti. Çmimet e vëzhgueshme dhe modelet e të dhënave janë zakonisht në dispozicion në tregjet e listuara për borxhet dhe letrat me vlerë të kapitalit, instrumentet derivative të tregtueshme dhe instrumentet që tregtohen në tregjet e letrave me vlerë të tilla si normat e interesit swap. Disponueshmëria e çmimeve të publikuara në tregje dhe e modelit të dhënave redukton nevojën e menaxhmentit për gjykim dhe vlerësim, dhe gjithashtu redukton pasigurinë në përcaktimin e vlerës së drejtë.

Disponueshmëria e çmimeve të publikuara në tregje dhe e modelit të dhënave ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur ndaj ndryshimeve në bazë të ndodhive specifike dhe kushteve të përgjithshme në tregjet financiare.

Për instrumente më të ndërlikuara, Banka përdor modele të veçanta të vlerësimit, të cilat zakonisht janë të zhvilluara nga modele të njohura të vlerësimit. Disa ose të gjitha të dhënat e rëndësishme në këto modele mund të mos janë të vëzhgueshme në treg, dhe janë nxjerrë nga çmimet ose normat e tregut, ose janë vlerësuar bazuar në supozime. Modelet e vlerësimit që përdorin të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi dhe vlerësimi në përcaktimin e vlerës së drejtë. Gjykimi dhe vlerësimi i menaxhmentit zakonisht janë të nevojshme për zgjedhjen e modelit të vlerësimit që do të përdoret, përcaktimin e flukseve monetare të pritshme të instrumentit finansiar që vlerësohet, përcaktimin e probabilitetit të dështimit në pagesë nga pala e tjetër dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme skontuese.

#### **Kreditë për klientët**

Kreditë paraqiten si neto, duke hequr provizonet për rënien në vlerë. Portofoli i kredive të Bankës ka një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsishtë të barabartë me vlerën e tij kontabël për shkak të normave të interesit të cilat janë të përafërtë me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të kredive është subjekt i ripërcaktimit të çmimeve brenda një viti.

#### **Letrat me vlerë**

Vlera e drejtë e letrave me vlerë është e bazuar në çmimet e tregut ose çmimet e ndërmjetësuesve/ agjentëve të shitjes në shitjen e letrave me vlerë, Kur ky informacion nuk është i disponueshëm, vlera e drejtë është llogaritur duke përdorur modelin e skontimit të flukseve të mjeteve monetare bazuar në një kurbë aktuale të të ardhurave të përshtatshme për maturitetin e mbetur.

Bonot e thesarit kanë një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsishtë të barabartë me vlerën e tyre bartëse, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër dhe normave të kthimit, të cilat janë të përafërtë me normat e tregut. Vlera e drejtë e këtyre instrumenteve bazohet në metodën e nivelit 2 të përshkruar më lartë.

#### **Depozitat dhe huatë**

Depozitat me afat kanë një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsishtë të barabartë në vlerën e tyre kontabël, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër dhe normave të interesit të cilat janë të përafërtë me normat e tregut.

**Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në *EURO*, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

**4. Përdorimi I vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)****Vlera e drejtë**

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat kontabël dhe vlerat e drejta të pasurive dhe detyrimeve financiare si dhe analizon instrumentet financiare të matura në vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese, nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën matja e vlerës së drejtë kategorizohet:

31 dhjetor 2019		Vlera e drejtë				
	Shënim	Shuma bartëse	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Llogaritë dhe balancat me bankat	7	37,244,984	-	37,244,984	-	37,244,984
Investimet në letra me vlerë	8	113,609,245	105,911,833	7,697,412	-	113,609,245
Të arkëtueshmet nga BKT Shqipëria	25	25,139	-	25,139	-	25,139
Kreditë ndaj klientëve	9	306,393,983	-	306,393,983	-	306,393,983
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>		<b>457,273,351</b>	<b>105,911,833</b>	<b>351,361,518</b>	-	<b>457,273,351</b>
Depozitat e klientëve	13	449,152,204	-	449,152,204	-	449,152,204
Detyrimet ndaj bankave	14	5,435,478	774,405	4,661,073	-	5,435,478
Huazimet	16	22,283,169	-	22,283,169	-	22,283,169
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>		<b>476,870,851</b>	<b>774,405</b>	<b>476,096,446</b>	-	<b>476,870,851</b>
31 dhjetor 2018		Vlera e drejtë				
	Shënim	Shuma bartëse	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Llogaritë dhe balancat me bankat	7	18,278,042	-	18,278,042	-	18,278,042
Investimet në letra me vlerë	8	76,967,698	68,592,401	8,375,297	-	76,967,698
Detyrimet ndaj BKT Shqipërisë	25	12,801,636	-	12,801,636	-	12,801,636
Kreditë ndaj klientëve	9	242,918,160	-	242,918,160	-	242,918,160
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>		<b>350,965,536</b>	<b>68,592,401</b>	<b>282,373,135</b>	-	<b>350,965,536</b>
Depozitat e klientëve	13	351,354,331	-	351,354,331	-	351,354,331
Detyrimet ndaj bankave	14	17,859,118	-	17,859,118	-	17,859,118
Huazimet	16	4,085,314	-	4,085,314	-	4,085,314
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>		<b>373,298,763</b>	-	<b>373,298,763</b>	-	<b>373,298,763</b>

## **Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

---

### **5. Menaxhimi i rrezikut financiar**

#### **(a) Të përgjithshme**

Banka i ekspozohet rreziqeve të mëposhtme nga instrumentet financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziqet e tregut
- Rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacione rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit nga rreziqet më lartë, qëllimet e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon të drejtën për të marrë mjete monetare ose ndonjë pasuri tjetër financiar nga një palë tjetër (pasuri financiar) ose detyrimin për të dhënë mjete monetare ose pasuri tjetër financiare tek një palë tjetër (detyrim financiar). Instrumentet financiare sjellin rreziqe të caktuara për Bankën. Rreziqet më të rëndësishme me të cilat përballet Banka janë rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit dhe rreziku i tregut. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e valutave të huaja, rrezikun e normës së interesit dhe rrezikun e cmimeve të tjera.

#### **Struktura e menaxhimit të riskut**

Bordi drejtues i BKT-së ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikqyrjen e strukturës së menaxhimit të rrezikut. Bordi ka themeluar komitetin e bankës pér pasuri dhe detyrime (KPD) në Zyrën Qendrore, Grupin e menaxhimit të riskut dhe komitetet e kreditimit, të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut në fushat e tyre të caktuara. Të gjitha këto organe i raportojnë rregullisht bordit të drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të riskut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që has Banka, për të vendosur kufizime të rrezikut dhe kontolle të përshtatshme, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontolleve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Banka, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjesid kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin çdo punonjës do të kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i auditimit në Zyrën Qendrore është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut të Bankës, dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së menaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Komiteti i auditimit ndihmohet në kryerjen e detyrave nga auditimi i brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr kontolle të rregullta dhe të rastit për procedurat dhe kontrolllet e menaxhimit, rezultatet e të cilave raportohen tek komiteti i auditimit.

#### **(b) Risku kreditor**

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përbushë detyrimet kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga kreditë e Bankës për klientët, për bankat e tjera dhe nga letrat me vlerë. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor (si rrezikun individual të klientit për mospagesë, rrezikun e vendit dhe të sektorit). BKT – Kosova ka formuar një komitet kreditor për të mbikëqyrur miratimin e kërkesave për kreditë deri në shumën 500,000 Euro. Kërkesat kreditore në shuma mbi 500,000 Euro miratohen vetëm me vendimin e bordit të drejtorëve. Ka një përqendrim të vazhdueshëm për mbikqyrjen e cilësisë së kredive të dhëna si në kohën e miratimit dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së të tyre.

Çdo njësie biznesi i kërkohet të jetë në përputhje me politikat dhe procedurat e kreditimit të Bankës. Auditime të rregullta të njësive të biznesit dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut janë ndërmarrë nga auditimi i brendshëm.

**Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
 (Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

**5. Menaxhimi i rrezikut finanziar (vazhdim)****(b) Risku kreditor (vazhdim)****i. Ekspozimi maksimal kreditor**

Vlera kontabë lbruto e aseteve financiare të paraqitura më poshtë, paraqet gjithashtu ekspozimin maksimal të Bankës ndaj rrezikut kreditor që rrjedh nga këto asete. Ekspozimet maksimale ndaj rrezikut të kredisë përpara kolateralit dhe rregullimeve të tjera të kredisë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë paraqitur si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Kreditë për klientët, neto	306,393,983	242,918,160
Llogaritë në banka	37,244,984	18,278,042
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	25,139	12,801,636
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	105,911,832	68,592,401
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	7,697,413	8,375,297
Garancitë financiare dhe letrat e kreditit	12,289,809	15,690,735
<b>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor</b>	<b>469,563,160</b>	<b>366,656,271</b>

**Kreditë dhe letrat me vlerë të provizionuara**

Kreditë dhe letrat me vlerë të provizionuara janë kredi dhe letra me vlerë për të cilat Banka konstaton se është e mundshme që ajo nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë principalin dhe interesin sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes së kredisë/të letrave me vlerë. Këto kredi vlerësohen nga A në D në sistemin e brendshëm të klasifikimit të Bankës dhe komiteti i rrezikut i BKT-së është i angazhuar me kategorizimin e konsumatorëve dhe rezultatit të tyre sipas kategorive përkatëse. Ky komitet vendos për ndryshimet e klasifikimit dhe merr veprimet e nevojshme sipas procedurave të monitorimit.

Komiteti i rrezikut i klasifikon kreditë sipas këtyre faktorëve:

- Aftësia për të paguar
- Gjendja financiare
- Aftësitë e menaxhimit
- Kolaterali dhe garantuesit
- Struktura e kredisë
- Industria dhe ekonomia

**Kreditë me vonesë por jo të provizionuara**

Kreditë dhe letra me vlerë, ku interesit kontraktual ose pagesat e principalit janë me vonesë, por Banka beson se provizionimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit në dispozicion dhe / ose fazës e arkëtimit të shumës së huasë.

**Kredi me kushte të rinegociueshme**

Kreditë me kushte të rinegociueshme janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe ku Banka ka bërë lëshime të cilat përndryshe nuk do të ndërmerrreshin. Pasi kredia është ristrukturuar ajo qëndron në të njëjtën kategori pavarësisht nga performanca e përmirësuar pas ristrukturimit.

**5. Menaxhimi i rrezikut finansiar (vazhdim)****(b) Rreziku kreditor (vazhdim)***Lejimet për provizione*

Banka vendos një kufi të lejuar për humbjet nga provisionet që përfaqëson parashikimin e saj për humbjet nga portofoli i kredive. Detaje të mëtejshme mbi metodologjinë e përllogaritjes janë paraqitur në Shënimin 3 (e)(vii).

*Politika e shlyerjeve*

Banka shlyen një balancë të kredisë/letrave me vlerë (dhe çdo lejim përkatës të humbjeve nga provisionet) me vendim të Bordit të Drejtoreve, në përputhje me rregulloret e Bankës Qëndrore të Kosovës. Vendimi për shlyerje ndërmerr pas shqyrtimit të informacioneve të tilla si: shfaqja e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin finansiar të huamarrësit/emetuesit, huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajnë më detyrimin, ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të paguar ekspozimin e tërë.

	Huatë për klientët		
	Individ	Korporata	Gjithsej
<b>31 dhjetor 2019</b>			
Standarde	114,024,630	184,374,435	298,399,065
Vrojtuese	1,497,090	3,048,012	4,545,102
Nën standarde	662,060	3,491,214	4,153,274
Të dyshimta	556,342	2,179,739	2,736,081
Humbje	2,403,661	3,256,492	5,660,153
<b>Gjithsej</b>	<b>119,143,783</b>	<b>196,349,892</b>	<b>315,493,675</b>
Minus: Provizioni për humbjet nga kreditë	(2,953,594)	(6,146,097)	(9,099,692)
<b>Gjithsej kreditë, neto nga provisionet</b>	<b>116,190,189</b>	<b>190,203,795</b>	<b>306,393,983</b>

	Huatë për klientët		
	Individ	Korporata	Gjithsej
<b>31 dhjetor 2018</b>			
Standarde	88,676,125	146,000,771	234,676,896
Vrojtuese	1,306,080	2,611,230	3,917,310
Nën standarde	1,277,849	4,693,550	5,971,399
Të dyshimta	627,761	1,120,981	1,748,742
Humbje	3,147,477	6,161,578	9,309,055
<b>Gjithsej</b>	<b>95,035,292</b>	<b>160,588,110</b>	<b>255,623,402</b>
Minus: Provizioni për humbjet nga kreditë	(4,165,276)	(8,539,966)	(12,705,242)
<b>Gjithsej kreditë, neto nga provisionet</b>	<b>90,870,016</b>	<b>152,048,144</b>	<b>242,918,160</b>

Më poshtë është paraqitur një analizë e kolateralit e marrë gjatë viteve:

	Huatë për klientët		
	Individ	Kompani	Gjithsej
<b>31 dhjetor 2019</b>			
Pronat e banimit, komerciale ose industriale	350,783,232	104,227,225	455,010,457
Pasuritë financiare	10,986,755	10,369,922	21,356,677
Të tjera	151,998,240	71,073,406	223,071,646
<b>Gjithsej</b>	<b>513,768,227</b>	<b>185,670,553</b>	<b>699,438,780</b>

	Huatë për klientët		
	Individ	Kompani	Gjithsej
<b>31 dhjetor 2018</b>			
Pronat e banimit, komerciale ose industriale	98,443,990	340,209,728	438,653,718
Pasuritë financiare	9,205,298	9,542,281	18,747,579
Të tjera	78,461,565	164,625,755	243,087,320
<b>Gjithsej</b>	<b>186,110,853</b>	<b>514,377,764</b>	<b>700,488,617</b>

**5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(c) Rreziku i likuiditetit**

**Rreziku i likuiditetit** është rreziku që Banka do të ndeshët me vështirësi në përbushjen e obligimeve të saj të lidhura me detyrimet financiare që janë vendosur me dhënien e parave ose të ndonjë pasurie tjetër financiare. Qëllimi i Menaxhimit të Rrezikut të Likuiditetit (MRL) është të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, që vazhdimisht do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përbushur në kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu dhe të pafavorshme, pa pësuar humbe të papranueshme apo të rrezikoje dëmtimin e reputacionit të Bankës. Politika e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit të Bankës përfshin atë se si Banka identifikon, mat, monitoron dhe kontrollon këtë rrezik.

**Organzimi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit:** Organizimi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit të bankës përfshin dy organe të ndryshme në monitorimin dhe menaxhimin e likuiditetit. Përfshirja e organeve të ndryshme ndihmon në shpërndarjen e qartë të përgjegjësisë për monitorimin / raportimin dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Menaxhimi ditor i likuiditetit i përket Thesarit dhe FI Grupit, por monitorimi ditor i rrezikut të likuiditetit dhe përputhshmëria me limitet i takon Grupit të Menaxhimit të Riskut. Qëllimi kryesor i Grupit të Menaxhimit të Riskut, i cili kryen përbledhjen ditore të raporteve të MRL, është të sigurojë një sinjal paralajmëruesh të hershëm të rrezikut të likuiditetit për menaxhmentin e lartë të Bankës.

**Raportet e menaxhimit të riskut të likuiditetit:** Politika e MRL të bankës përfshin raporte ditore dhe mujore të cilat shqyrtohen dhe monitorohen nga Departamenti i Rrezikut Operacional dhe të Tregut. Raportet ditore përfshijnë tabelën me daljet kumulative maksimale të keshit dhe tabelën e ndarjes së aseteve dhe pasiveve kumulative, të cilat kontrollojnë hyrjet dhe daljet ditore dhe mujore të likuiditetit deri në maturimin 1-vjeçar sipas skenarit të "biznesit si zakonisht". Raportet mujore përfshijnë stres test tabelat e likuiditetit, të cilat kontrollojnë rrjedhen e hyrjeve dhe daljeve ditore dhe mujore të likuiditetit sipas skenarëve të veçantë të bankës dhe situatës specifike të tregut deri në maturimin 3 mujor.

Qasja e MRL së Bankës rezulton në zbrazëtira pozitive të likuiditetit për të gjitha fazat kohore deri në një vit më 31 dhjetor 2019.

**Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

**5. Menaxhimi I rrezikut finanziar (vazhdim)**

**(c) Rreziku I likuiditetit (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2019, pasuritë, detyrimet dhe kapitali aksionar i Bankës kanë maturitet të mbetur si në vazhdim

	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1-3 muaj</b>	<b>3-12 muaj</b>	<b>1-5 vite</b>	<b>Mbi 5 vite</b>	<b>Non specified</b>	<b>Total</b>
<b>Asetet</b>							
Paraja dhe llogaritë në Bankën Qëndrore	38,501,618	-	-	-	-	30,288,265	68,789,883
Llogaritë në banka	30,573,029	5,630,779	-	1,041,176	-	-	37,244,984
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	188,059	446,007	5,110,041	67,775,540	32,392,185	-	105,911,832
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	91,028	29,987	7,576,398	-	-	7,697,413
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	25,139	-	-	-	-	-	25,139
Kreditë dhe paradhënet për klientët	13,573,911	22,985,091	140,877,668	92,971,201	35,986,112	-	306,393,983
Asetet tjera	2,875,019	-	2,293,846	-	-	-	5,168,865
<b>Total asetet</b>	<b>85,736,775</b>	<b>29,152,905</b>	<b>148,311,542</b>	<b>169,364,315</b>	<b>68,378,297</b>	<b>30,288,265</b>	<b>531,232,099</b>
<b>Liabilities</b>							
Depozitat e klientëve	226,055,045	15,777,392	99,794,421	107,525,346	-	-	449,152,204
Detyrimet ndaj bankave	1,436,133	1,381,979	1,842,961	-	-	-	4,661,073
Detyrimet ndaj BKT Shqipëria	774,405	-	-	-	-	-	774,405
Tatimi i shtyrë detyrim	-	196,960	-	-	-	-	196,960
Akrualet dhe detyrimet e tjera	2,299,888	-	-	-	-	-	2,299,888
Huazimet	18,169	-	4,037,222	18,227,778	-	-	22,283,169
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>230,583,640</b>	<b>17,356,331</b>	<b>105,674,604</b>	<b>125,753,124</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>479,367,699</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(144,846,865)</b>	<b>11,796,574</b>	<b>42,636,938</b>	<b>43,611,191</b>	<b>68,378,297</b>	<b>30,288,265</b>	<b>51,864,400</b>
<b>Pozicioni kumulativ neto</b>	<b>(144,864,865)</b>	<b>(133,050,291)</b>	<b>(90,413,353)</b>	<b>(46,802,162)</b>	<b>21,576,135</b>	<b>51,864,400</b>	<b>-</b>

Raportet e MRL-së janë gjeneruar për valutën euro dhe për pasqyrën e përgjithshme të gjendjes financiare. Janë përcaktuar limitet maksimale të rrjedhës së parasë së gatshme, të cilat menaxhohen dhe monitorohen në baza ditore.

Pasuritë dhe detyrimet paraqiten në maturimin e tyre të mbetur në tabelën e mësipërme. Hendeqet e likuiditetit komultaiv janë negative për shkak të përqendrimit të lartë të depozitave (llogarive rrjedhëse).

**Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

**5. Menaxhimi I rrezikut financiar (vazhdim)**

**(c) Rreziku I likuiditetit (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2018 pasuritë, detyrimet dhe kapitali aksionar i Bankës kanë maturitet të mbetur si në vazhdim:

	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1-3 muaj</b>	<b>3-12 muaj</b>	<b>1-5 vite</b>	<b>Mbi 5 vite</b>	<b>I pa specifikuar</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Pasuria</b>							
Paraja dhe llogaritë në Bankën Qëndrore	28,797,262	-	-	-	-	24,522,489	53,319,751
Llogaritë në banka	14,218,885	3,036,384	-	1,022,773	-		18,271,569
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	492,085	22,615,343	37,536,229	7,948,744		68,453,409
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	3,500,440	2,417,660	2,457,197		8,354,469
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	12,801,636	-	-	-	-		12,801,636
Kreditë dhe paradhëni për klientët	4,764,259	3,401,866	40,246,225	123,760,749	70,799,061		247,370,257
Pasuritë tjera	1,319,934	-	2,636,367	-	-		4,226,803
<b>Gjithsej pasuria</b>	<b>61,901,976</b>	<b>6,930,335</b>	<b>68,998,375</b>	<b>164,683,411</b>	<b>81,205,002</b>	<b>24,522,489</b>	<b>412,797,894</b>
 <b>Detyrimet</b>							
Depozitat e klientëve	171,806,846	16,426,178	84,716,420	78,202,496	202,391	-	351,354,331
Detyrimet ndaj bankave	16,082,806	-	1,776,312	-	-	-	17,859,118
Tatimi i shtyrë detyrim	-	-	-	-	-	-	213,306
Akrualet dhe detyrimet e tjera	1,652,700	-	-	-	-	-	1,652,700
Huazimet	-	-	4,085,314	-	-	-	4,085,314
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>189,542,352</b>	<b>16,426,178</b>	<b>90,578,046</b>	<b>78,202,496</b>	<b>202,391</b>	<b>-</b>	<b>374,951463</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(127,640,376)</b>	<b>(9,495,843)</b>	<b>(21,579,671)</b>	<b>86,480,915</b>	<b>81,002,611</b>	<b>24,522,489</b>	<b>37,633,716</b>
<b>Pozicioni kumulativ neto</b>	<b>(127,640,376)</b>	<b>(137,136,219)</b>	<b>(158,715,890)</b>	<b>(72,234,975)</b>	<b>8,767,636</b>	<b>33,290,125</b>	<b>-</b>

**Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

**5. Menaxhimi i rrezikut finanziar (vazhdim)**

**(d) Rreziku i tregut**

**1) Rreziku i valutave të huaja**

Rreziku i valutave të huaja është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit të valutave të huaja. Banka e menaxhon këtë rrezik duke vendosur dhe monitoruar limitet mbi pozicionet e hapura dhe gjithashtu duke siguruar që këto pozicione të mbeten në përputhje me udhëzimet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe marrëveshjet e brendshme operative të Bankës. Banka ka procedura përkohore kontrollin e pavarur të pozicioneve të hapura në valutat e huaja. Grupi i Thesarit dhe Institucioneve Financiare menaxhon pozicionet e valutave të huaja dhe balancon përhapjen e valutave të Bankës në mënyrë të vazhdueshme. Tabelat vijuese paraqesin vlerën përkatëse të pasurive, detyrimeve dhe kapitalit aksionar sipas valutave më 31 dhjetor 2018 dhe 2019:

2019	EUR	ALL	USD	GBP	CHF	Other	Total
<b>Pasuria</b>							
Paraja dhe llogaritë në Bankën Qendrore	56,248,716	144	422,137	732,981	11,301,953	83,952	68,789,883
Llogaritë në banka	32,399,264	94,442	806,953	3,431,694	493,737	18,894	37,244,984
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	92,954,700	-	9,376,259	-	3,580,873	-	105,911,832
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	7,697,413	-	-	-	7,697,413
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	-	14,792	-	-	10,347	-	25,139
Kreditë përkohore	305,579,425	-	814,558	-	-	-	306,393,983
Asete të tjera	5,245,509	(109,612)	14,451	6,687	11,819	11	5,168,865
<b>Total asetet</b>	<b>492,427,614</b>	<b>(234)</b>	<b>19,131,771</b>	<b>4,171,362</b>	<b>15,398,729</b>	<b>102,857</b>	<b>531,232,099</b>
<b>Detyrimet</b>							
Depozitat e klientëve	433,746,576	371	8,196,247	1,890,593	5,318,407	10	449,152,204
Detyrimet ndaj bankave	4,024	-	1,427,293	25	3,229,731	-	4,661,073
Detyrimet ndaj BKT Shqipëria	418,278	-	355,668	403	-	56	774,405
Tatimi i shtyrë detyrim	196,960	-	-	-	-	-	196,960
Akrualët dhe detyrimet e tjera	2,170,631	-	111,919	(9,932)	27,270	-	2,299,888
Huamarrjet	22,283,169	-	-	-	-	-	22,283,169
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>458,819,638</b>	<b>371</b>	<b>10,091,127</b>	<b>1,881,089</b>	<b>8,575,408</b>	<b>66</b>	<b>479,367,699</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>33,607,976</b>	<b>(605)</b>	<b>9,040,644</b>	<b>2,290,273</b>	<b>6,823,321</b>	<b>102,791</b>	<b>51,864,400</b>
<b>Pozicioni neto (hendeku)</b>	<b>33,607,976</b>	<b>33,607,371</b>	<b>42,648,015</b>	<b>44,938,288</b>	<b>51,761,609</b>	<b>51,864,400</b>	<b>-</b>

**Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në **EURO**, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

**5. Menaxhimi i rrezikut finansiar (vazhdim)**

**(d) Rreziku i tregut (vazhdim)**

**1) Rreziku i valutave të huaja (vazhdim)**

2018	EUR	ALL	USD	GBP	CHF	Other	Total
<b>Asetet</b>							
Paraja dhe llogaritë në Bankën Qëndrore	45,302,024	142	590,690	382,206	7,044,689	-	53,319,751
Llogaritë në banka	15,752,108	-	2,056,060	184,292	285,582	-	18,278,042
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	66,237,824	-	2,320,201	6,333	28,043	-	68,592,401
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	3,500,440	-	4,874,857	-	-	-	8,375,297
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	11,351,172	72,316	740,490	1,213,169	(575,511)	-	12,801,636
Kreditë për klientët	242,917,329	-	831	-	-	-	242,918,160
Asetet tjera	4,085,314	6,934	-	-	-	-	3,956,301
<b>Gjithsej asetet</b>	<b>389,010,264</b>	<b>79,392</b>	<b>10,583,129</b>	<b>1,786,000</b>	<b>6,782,803</b>	-	<b>408,241,588</b>
<b>Detyrimet</b>							
Depozitat e klientëve	331,500,948	580	11,354,563	1,785,690	6,712,550	-	351,354,331
Detyrimet ndaj bankave	17,859,118	-	-	-	-	-	17,859,118
Akrualët dhe detyrimet e tjera	1,487,444	78,813	22,895	10,457	53,091	-	1,652,700
Huazimet	4,085,314	-	-	-	-	-	4,085,314
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>354,932,824</b>	<b>79,393</b>	<b>11,377,458</b>	<b>1,796,147</b>	<b>6,765,641</b>	-	<b>374,951,463</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>34,077,440</b>	<b>(1)</b>	<b>(794,329)</b>	<b>(10,147)</b>	<b>17,162</b>	-	<b>33,290,125</b>
<b>Pozicioni neto (hendeku)</b>	<b>34,077,440</b>	<b>34,077,439</b>	<b>33,283,110</b>	<b>33,283,110</b>	<b>33,290,125</b>	<b>33,290,125</b>	<b>66,580,250</b>

**Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvç rasteve kur specifikohen ndryshe)

---

**5. Menaxhimi i rrezikut finanziar (vazhdim)****(d) Rreziku i tregut (vazhdim)****1) Rreziku i valutave të huaja (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme tregon ndjeshmérinë e Bankës për rrezikun e valutave të huaja. Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat valutorë të shprehur në valutë të huaj në fund të vitit, duke bërë kështu rregullimin e vlerës së tyre kur kursi i këmbimit të valutave të huaja ndryshon me 1% dhe /ose 5%. Shuma e kundërt poshtë shënon një ulje të fitimit ose humbjes që shfaqet në rast se Euro rrit vlerën e saj në krahasim me valutat e huaja me 1% dhe /ose 5%. Kur vlera e Euro në krahasim me valutat e huaja zvogëlohet për 1% dhe / ose 5%, efekti në fitim ose humbje është i barabartë, por me indeks të kundërt siç tregohet në tabelën e mëposhtme:

	Ndryshimi në	Fitimi ose humbja
në EUR	2019	2019
ALL	5%	(32)
USD	5%	411,436
GBP	1%	22,896
CHF	5%	341,166
Të tjera	5%	5,140

**Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvrëç rasteve kur specifikohen ndryshe)

**5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(d) Rreziku i tregut (vazhdim)****2) Rreziku i normave të interesit**

Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Departamenti i thesarit në Degën Qendrore menaxhon rrezikun e normës së interesit nëpërmjet monitorimit të kushteve të tregut dhe duke marrë vendime të nevojshme të caktimit të çmimeve të reja apo ndryshime në aprovime me miratimin e Komitetit të pasurive dhe detyrimeve në Degën Qendrore. Analiza e ndjeshmërisë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj normave të interesit për pasuritë dhe detyrimet financiare duke supozuar se shumat e tyre të papaguara në datën e raportimit ishin të papaguara për tërë vitin.

Normat mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të aseteve dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 dhjetor 2019 janë si në vijim:

	<i>USD</i>	<i>Euro</i>
<b>Asetet</b>		
Paraja dhe llogaritë në Bankën Qëndrore	-	-
Kreditë dhe avanset për bankat	-	-
Kreditë për klientët	6.00%	5.95%
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	6.69%	3.12%
<b>Detyrimet</b>		
Depozitat e klientëve dhe detyrimet ndaj bankave	1.90%	1.06%

Normat mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	<i>USD</i>	<i>Euro</i>
<b>Pasuritë</b>		
Paraja dhe llogaritë në Bankën Qëndrore	-	-
Kreditë dhe avanset për bankat	-	-
Kreditë për klientët	5.00%	6.13%
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	2.04%
<b>Detyrimet</b>		
Depozitat e klientëve dhe detyrimet ndaj bankave	1.82%	1.79%

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës për një rritje ose rënje të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të normave si dhe një pasqyrë qëndrueshme e pozicionit financiar) është si në vijim:

2019	Skenarët deri në 1 vit		Skenarët mbi 1 vit	
	100 bp	100 bp	100 bp	100 bp
Zbritje		Rritje		Rritje
Efekti i fitimit (l humbjes) së vlerësuar	(923,110)	923,110	1,422,778	(1,422,778)

2018	Skenarët deri në 1 vit		Skenarët mbi 1 vit	
	100 bp	100 bp	100 bp	100 bp
Decrease		Increase		Increase
Efekti i fitimit (l humbjes) së vlerësuar	(1,610,195)	1,610,195	1,920,060	(1,920,060)

**Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvèç rasteve kur specifikohen ndryshe)

**5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(d) Rrezikut i tregut (vazhdim)**

**2) Rreziku i normave të interesit (vazhdim)**

Datat e vendosjes së çmimeve të reja të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si në vijim:

	<i>Deri në 1 muaj</i>	<i>1-3 muaj</i>	<i>3-12 muaj</i>	<i>1-5 vite</i>	<i>Mbi 5 vite</i>	<i>I pa specifikuar</i>	<i>Gjithsej</i>
<b>2019</b>							
<b>Pasuritë</b>							
Paraja dhe llogaritë në Bankën Qëndrore	38,501,618	-	-	-	-	30,288,265	68,789,883
Llogaritë në banka	30,573,029	5,630,779	-	1,041,176	-	-	37,244,984
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	188,059	446,007	5,110,041	67,775,540	32,392,185	-	105,911,832
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	91,028	29,987	7,576,398	-	-	7,697,413
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	25,139	-	-	-	-	-	25,139
Kreditë për klientët	13,573,911	22,985,091	140,877,668	92,971,201	35,986,112	-	306,393,983
<b>Gjithsej</b>	<b>82,861,756</b>	<b>29,152,905</b>	<b>146,017,696</b>	<b>169,364,315</b>	<b>68,378,297</b>	<b>30,288,265</b>	<b>526,063,234</b>
<b>Detyrimet</b>							
Depozitat e klientëve dhe detyrimet ndaj bankave	227,491,178	17,159,371	101,637,382	107,525,346	-	-	453,813,277
Huamarrjet	18,169	-	4,037,222	18,227,778	-	-	22,283,169
<b>Gjithsej</b>	<b>227,509,347</b>	<b>17,159,371</b>	<b>105,674,604</b>	<b>125,753,124</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>476,096,446</b>
<b>2018</b>							
<b>Asetet</b>							
Paraja dhe llogaritë në Bankën Qëndrore	28,797,262	-	-	-	-	24,522,489	53,319,751
Llogaritë në banka	14,218,885	3,036,384	-	1,022,773	-	-	18,278,042
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	492,085	22,615,343	37,536,229	7,948,744	-	68,592,401
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	3,500,440	2,417,660	2,457,197	-	8,375,297
Të arkëtueshme nga zyra qendrore	12,801,636	-	-	-	-	-	12,801,636
Kreditë për klientët	4,764,259	3,401,866	40,246,225	123,706,749	70,799,061	-	242,918,160
<b>Gjithsej asetet</b>	<b>60,582,042</b>	<b>6,930,335</b>	<b>66,362,008</b>	<b>164,683,411</b>	<b>81,205,002</b>	<b>24,522,489</b>	<b>404,285,287</b>
<b>Detyrimet</b>							
Depozitat e klientëve dhe detyrimet ndaj bankave	187,889,651	16,426,179	86,492,732	78,202,496	202,391	-	369,213,449
Huamarrjet	-	-	4,085,314	-	-	-	4,085,314
<b>Gjithsej Detyrimet</b>	<b>187,889,651</b>	<b>16,426,179</b>	<b>90,578,046</b>	<b>78,202,496</b>	<b>202,391</b>	<b>-</b>	<b>373,298,763</b>

## **Banka Kombetare Tregtare Kosovë sh.a.**

Shënimet shpjeguese për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në EURO, përvç rasteve kur specifikohen ndryshe)

---

### **5. Menaxhimi I rrezikut financiar (vazhdim)**

#### **(e) Rreziqet operacionale**

Rreziku operacional është rreziku i humbjes direkte dhe indirekte si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me operacionet e Bankës, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën, si dhe nga faktorë të jashtëm përvç rreziqeve të kredisë, tregut dhe të likuiditetit, siç janë ato që rrjedhin nga kërkosat ligjore dhe rregullatore dhe standardet e sjelljes organizative të pranuara në përgjithësi. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e Bankës. Qëllimi i Bankës është të menaxhojë rrezikun operacional si dhe të balancojë shmangjen e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të saj me kosto të përgjithshme efektive dhe të shmang procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Zbatimi i kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme për menaxhimin e rrezikut operacional dhe të zbatuara në bashkëpunim me Zyrën Qëndrore.

Objektiv i bankës është që të menaxhojë rrezikun operacional ashtu që të balancojë shmangjen e humbjeve financiare dhe dëmtimit të reputacionit të bankës me efektivitet të përgjithshëm të kostos si dhe të shmang procedurat e kontrollës që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Zbatimi i kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional mbështetet nga standarde të përgjithshme për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkosat për ndarjen e përshtatshme të detyrate, duke përfshirë edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkosat për barazimin dhe monitorimin e transaksioneve
- përputhja me kërkosat rregullative dhe ligjore
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave
- kërkosat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për administrimin e rreziqeve të identifikuara
- kërkosat për raportimin e humbjeve operacionale dhe propozimet e veprimeve përmirësuese
- zhvillimin e planeve kontingjente
- trajnimi dhe zhvillimi profesional
- standardet etike dhe të biznesit
